



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 1107/4 prot.

Tiranë më 20.06.2024

V E N D I M

Nr. 10 , datë 20.06.2024

PËR LEJIMIN E TRANSFERIMIT NDËRKOMBËTAR

Në mbështetje të nenit 9 dhe pikës 1 të nenit 26 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), pas shqyrtimit të kërkesës administruar me nr. 1107 prot., datë 24.04.2024, për pajisje me autorizim për transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale nga transferuesi “*Tirana Bank SHA*” tek marrësi “*Udemy Inc*”, i vendosur në Delaware, Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA).

KONSTATOVA SE:

Subjekti kontrollues “*Tirana Bank SHA*” ka kërkuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), pajisjen me autorizim për transferimin e të dhënave personale tek marrësi “*Udemy Inc*”, i vendosur në Delaware, SHBA.

Sipas deklarimeve të subjektit në Formularin e Aplikimit, për aprovimin e transferimit të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, administruar pranë Zyrës së Komisionerit, transferimi që kërkohet të autorizohet nga Komisioneri përmban elementët e mëposhtëm:

- i. Kategoria e të dhënave objekt transferimi:
 - Të dhënat e identifikimit (emër, mbiemër i punonjësit);
 - Adresa e e-mail të punonjësit.
- ii. Shteti ku do të realizohet transferimi: Delaware, SHBA.
- iii. Kategoria e subjekteve të cilëve u transferohen të dhëna personale janë:

- Punëmarrës;

iv. Frekuenca e transferimit është: Periodikisht.

- v. Lidhur me qëllimin i transferimit, deklarohet se: *“Tirana Bank SHA në kuadër të politikave të saj të brendshme për zhvillimin e burimeve njerëzore ka prokuruar dhe kontraktuar një platformë online për dhënien e mundësisë punonjësve të saj për ndjekjen e kurseve online, për nxitjen dhe zhvillimin e aftësive të tyre profesionale, rritjen në karrierë dhe njëkohësisht duke ofruar mundësinë e fleksibilitetit në kohë dhe cilësi në modulet e trajnimit.*

Udemy është një platformë model e mësimit/trajnimit online, e cila ofron një gamë të larmishme kurseesh të përgatitura nga instruktorë ekspertë. Në mënyrë që punonjësi të aksesojë këto kurse/module, nevojitet të krijojë llogarinë e përdoruesit të tij unik (user account) në platformë. Për krijimin e llogarisë së përdoruesit, nevojiten tre të dhëna të punonjësit: emri, mbiemri dhe adresa e postës elektronike (email) i punës”.

- vi. Ndërkohë, në Rubrikën 7 të Formularit të Aplikimit, rrethanat lidhur me përpunimin e subjekti transferues, ka deklaruar: *“Nëpërmjet “Tirana Bank SHA” dhe shoqërisë “Umedy Inc” është hartuar një marrëveshje bashkëpunimi ku, ndër të tjera në lidhje me:*

- *Kuadri i privatësisë së të dhënave – “Umedy Inc” është i vetë-certifikuar sipas kornizës së privatësisë së të dhënave.*
- *Klauzolën e “konfidencialitetit” - palët garantojnë se janë parashikuar të gjitha masat për mbrojtjen e të dhënave personale të aplikantëve të Tirana Bank SHA. Kompania “Umedy Inc” do të sigurojë që stafi i vet që angazhohet në përpunimin e të dhënave personale të jetë i informuar për natyrën konfidenciale të të dhënave personale, të ketë marrë trajnimin e duhur mbi përgjegjësitë e tyre dhe të ketë nënshkruar marrëveshje konfidencialiteti.*

Masat e sigurisë teknike dhe organizative të sigurisë të të dhënave – “Udemy Inc” ofron:

- *Masat e pseudonimizimit dhe enkriptimit të të dhënave personale;*
- *Masat për sigurimin e konfidencialitetit, integritetit, disponueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së vazhdueshme të sistemeve dhe shërbimeve të përpunimit;*
- *Masat për sigurimin e aftësisë për të rivendosur disponueshmërinë dhe aksesin në të dhënat personale në kohën e duhur në rast të një incidenti fizik ose teknik;*
- *Proceset për testimin, vlerësimin dhe vlerësimin e rregullt të efektivitetit të masave teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë e përpunimit;*
- *Masat për identifikimin dhe autorizimin e përdoruesit;*
- *Masat për lejimin e transferimit të të dhënave dhe sigurimin e asgjësimit të tyre.*

- vii. Në lidhje me Rubrikën 8, natyra e përpunimit dhe kohëzgjatja e tij, citohet se: *“Punonjës të përzgjedhur sipas planit të zhvillimit të tyre profesional, do të kyçen në*

platformë për të marrë trajnimet që ofrohen nga kompania. Afati i kontratës është 1 vit”.

Banka ka nënshkruar dokumentin “*Marrëveshja Master për Shërbime*” me “Umedy Inc”. Kjo marrëveshje në brendësinë e saj ka një seksion të dedikuar (seksioni 7) për të siguruar konfidencialitetin e informacionit.

Kohëzgjatja e ruajtjes së të dhënave, citojmë: “*Të dhënat do të mbahen vetëm përgjatë kohëzgjatjes së kontratës së bashkëpunimit mes Tirana Bank SHA dhe palës ofruese të shërbimit Udemy Inc*”.

Në bazë të Vendimit nr. 8, datë 31.10.2016 të Komisionerit “*Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale*”, SHBA nuk përfshihet në listën e vendeve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave.

Në këto kushte në zbatim të pikës 1, të nenit 9 të Ligjit, subjekti kontrollues “*Tirana Bank SHA*” është në kushtet ku transferimi duhet kryer pas marrjes së Autorizimit nga Komisioneri, mbi ligjshmërinë e realizimit të tij.

Për këtë qëllim, subjekti përveç Formularit të Aplikimit për aprovimin e transferimit të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, ka depozituar edhe një sërë dokumentesh në mbështetje të kërkesës së tij, për të legjitimuar transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale në marrësin e sipërcituar dhe konkretisht:

- Marrëveshja Master për Shërbime;
- Shtojca për përpunimin e të dhënave;
- Shtojca A – Përshkrimi i përpunimit;
- Shtojca B – Masat e Sigurisë Teknike dhe Organizative;
- Dhënie pëlqimi për transferimin e të dhënave në SHBA;
- Formular njoftimi.

Në mbështetje të dokumentacionit të paraqitur nga Kontrolluesi dhe analizimit të përmbajtjes së tyre rezulton se ky transferim të dhënash personale është në përputhje me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale, sipas akteve ndërkombëtare dhe vendase, dispozitat e Ligjit, si dhe me Udhëzimin nr. 41, datë 13.06.2014 të Komisionerit “*Për lejimin e disa kategorive të transferimeve ndërkombëtare të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale*”.

http://www.idp.al/images/Legjislacion/udhezime/udhezim_nr_42_date_22_korrik_2014.pdf
http://www.idp.al/images/Legjislacion/udhezime/udhezimi_nr_41_13062014.pdf

Sa më sipër, kërkesa për marrjen e autorizimit nga Komisioneri për transferimin e të dhënave personale nga kontrolluesi “*Tirana Bank SHA*”, plotëson kërkesat ligjore për t’u pajisur me Autorizim për transferimin e të dhënave personale të kërkuara.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 8, (pika 2, shkronja b), nenit 9, pika 2 dhe nenit 26 të Ligjit;

V E N D O S A :

1. Lejimin e transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale nga kontrolluesi “*Tirana Bank SHA*”, duke përcaktuar si më poshtë:

Kontrolluesi “*Tirana Bank SHA*” lejohet të transferojë tek marrësi i të dhënave “*Udemy Inc*”, i vendosur në SHBA, kategorinë e të dhënave personale “*punëmarrës*”, si më poshtë:

- Të dhënat e identifikimit (emër, mbiemër);
- Adresa e e-mail të punës.

Të dhënat e cituara më sipër do të transferohen vetëm për qëllimin e deklaruar nga transferuesi në Formularin e Aplikimit për autorizim mbi transferimin e të dhënave personale, e cila ka të bëjë me “*dhënien e mundësisë punonjësve të saj për ndjekjen e kurseve online, për nxitjen dhe zhvillimin e aftësive të tyre profesionale dhe rritjen në karrierë*”.

2. Të dhënat personale të lejuara për t’u transferuar (parashikuar në pikën 1), nuk do të ruhen më gjatë se kohëzgjatja e marrëdhënies kontraktuale të punësimit mes punëmarrësit dhe punëdhënësit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot më datë 20.06.2024

KOMISIONERI

Besnik Dervishi